



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, te Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019, e konform nenit 17 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 15 dhe 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datës -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, për parcelën P-72116046-00545-6, sipas vendimit paraprak 01-Nr-016-65712, të datës 29.11.2024 të miratuar nga Kuvendi i Komunës në Suharekë.

Neni 2

Komisioni nga neni 1, (një) i këtij vendimi përbehet prej 5, (pesë) anëtarëve dhe do të jetë kjo përbërje:

- 2.1 -----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
- 2.2 -----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
- 2.3 -----përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.4 -----përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.5 -----përfaqësuese nga sektori jo qeveritar

Neni 3

Komisioni do te kryen punën pas marrjes se vendimit paraprak nga Kuvendi i Komunës për dhënien ne shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësit e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, janë të përcaktuara me dispozita ligjore të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-10/2019”, komisioni ka autoritet, mandat dhe kompetencë të bëjë njoftimin publikë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, kushtet dhe kriteret specifik gjatë konkurrimit të hapur.

Neni 5

Obligohet zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, ti zhvillojnë procedurat e konkurrimit të hapur, shprehjes së interesit dhe vlerësimin e ofertave.

Neni 6

6.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohet nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Komunës së Suharekës.

6.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 7

Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 8

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI